



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2012

RELACION

Lenda: Mbi Performancën Financiare Buxhetore të KMDP-se për vitin 2011

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhenave Personale, në zbatimin e buxhetit të vitit 2011, është mbështetur në kërkesat me të domosdoshme institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhenave personale”.

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhenave Personale, në lidhje me performancën financiare buxhetore, ka vepruar me korrektesë në zbatim të Ligjit nr.10355 datë 02/12/2010”Për buxhetin e vitit 2011”, i ndryshuar, udhëzimit nr.4 datë 27/01/2011, ”Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”,

Në mbështetje të Ligjit nr. 10355 datë 02/12/2010”Për buxhetin e vitit 2011”, për vitin 2011, i ndryshuar me ligjin 10450, date 14.07.2011, është miratuar për Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhenave personale 1 program buxhetore :

- Programin me emertimin « Planifikim, menaxhim dhe administrim » ku përfshihet i gjithë buxheti i akorduar për funksionimin e aktivitetit të Zyres së Komisionerit për mbrojtjen e të Dhenave Personale

Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP) së hartuar gjatë procesit të PBA 2010-2012. Ky buxhet është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP: Mbështetja, organizimi, krijimi i kushteve të nevojshme për mirëfunksionimin e KMDP, përafrimin e harmonizimi legjislativ në fushën e të dhenave personale me legjislativin e vendeve të tjera të komunitetit evropian, me të drejtën komunitare si dhe privatesinë, imponimi i legjislativit të sotëm ekzistues vendas si dhe ndergjegjesimin dhe shtrirjen e fushës së zbatimit të ligjit në të gjithë vendin duke garantuar një transparencë totale të përpunimit dhe garantimit të të dhenave, siguri maksimale të të dhenave personale, intensifikimi i marrëveshjeve me strukturat e BE duke garantuar maksimalisht mbrojtjen e të dhenave personale të shtetasve në levizje ose rezident në BE. administrimi e menaxhimi i regjistrit elektronik dhe fizik të subjekteve kontrollues, monitorimin, rekomandimin dhe investigimet në kuadrin e mbrojtjes së të dhenave personale, mbi të cilat KMDP zhvillon përgjegjësitë e saj ligjore, për të garantuar maksimalisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në zbatim të Udhezimit nr. 4 datë 27/01/2011, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011", pika 3.6-Raportet e Monitorimit, po ju raportojme mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2011, sipas modeleve standarte të monitorimit.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndermarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhenave personale, në bazë dhe për zbatim të regjstrit të parashikimeve të vitit 2011, për periudhën 9 mujore ka prokuruar:

KMDP i është akorduar një fond i planifikuar prej **44.100 në mijë leke**, me ndryshimet e rialokimeve përbehet nga:

| | | | |
|--------------------------------|--------|-----------|----------------|
| Fondi i Pagave: | 27.265 | mijë leke | (zeri 600) |
| Fondi i Sigurimeve Shoqerore: | 4.200 | mijë leke | (zeri 601) |
| Fondi për Shpenzime Operative: | 8.149 | mijë leke | (zeri 602) |
| Fondi për Investime: | 4.000 | mijë leke | (zeri 231+230) |
| Transferime korrente: | 455 | mijë leke | (zeri 606) |
| Kuotizacione | 30 | mijë leke | (zeri 605) |

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, për periudhën e raportuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhenave personale, ka realizuar vlerën buxhetore në **41.972 në mijë lekë** ose 95%, të fondit të planifikuar vjetor.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore, (zeri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar, Nr. 225 datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës, organikes dhe kategorizimit të pagave të pozicioneve të punës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhenave Personale numri mesatar i punonjësve është realizuar 28 vetë, nga 29 vetë të miratuar. Shmangiet nga plani kanë ardhur si rezultat i dështimit të procedurave për mosplotësim të dokumentacionit dhe kriterëve të kualifikimit në pozicionin e Specialistes së Mardhenieve me jashtë pranë Dejtorisë së Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Mardhenieve me Jashtë. Aktualisht kanë rifilluar procedurat e rekrutimit, në zbatim të Ligjit nr.8549, datë 11.11.1999" Statusi i nepunesit

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shpërblimeve, si dhe i sigurimeve shoqerore, për këtë periudhë, është realizuar respektivisht 1 25700 (në mijë leke) për paga si dhe, 3872 në mijë leke për kontribute në sigurimet shoqerore e shëndetësore ose 94 % e fondit të planifikuar vjetor.

Fondi për shpenzim investime (zeri 231), nga vlera e përgjithshme prej 4,000 (në mijë leke) për periudhën e raportuar, është prokuruar dhe realizuar në masën 3950 në mijë leke ose 99 % e fondit të planifikuar vjetor

Gjatë vitit 2011, objektivat prioritarë në drejtim të DSHM ka qenë ndjekja e realizimit të procedurave të prokurimeve në mbështetje të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, udhëzimit nr.2 "Për procedurën e blerjeve të vogla", mbi bazën e kërkesave dhe fondeve të alokuara sipas projekteve të miratuara e për investime e konkretisht janë realizuar investimet e mëposhtme.

- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Blerjen pajisjeve kompjuterike”, per plotësimin e kushteve optimale ne realizimin ne kohe e cilësi te detyrave .\
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Blerja dhe instalimi e centralit të brendshëm telefonik” i cili do të mundësojë komunikimin e brendshëm dhe te jashtem nepermjet pritjes dhe transferimit automatik te thirrjeve si dhe monitorimin ne menyre te detajuar te telefonatave ne kohe dhe impulse ,me ane te se ciles do krijohet mundesia e përdorimit me efektivitet te shpenzimeve telefonike drejt minimizimit te shpenzimeve konkrete.
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Ndertimi i rrjetit te brendshme kompjuterik” i cili do te mundesoje lidhjen e te gjithë përdoruesve me serverin qendror.
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Blerje pajisje kondicionuese”per zyrat per krijimin e kushteve optimale te punonjësve .
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Pajisja e dhomës së serverit” me bazën materiale dhe pajisjet me te domosdoshme për krijimin e kushteve optimale te sigurise se dhenave qe do te permbaje.
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave me objekt prokurimi “Sistem infoprmatik per menaxhimin e te dhenave te protokollit dhe komunikimeve elektronike”” alokuar nga ministria e Financave ne Projektin “Intranet” realizuar ne vleren 984 ne mije leke. Jane ndjekur procedurat e tenderimit me proceduren “kerkese me prpozim” e pas deshtimit te tyre dy here radhazi per mungese konkurence eshte ndjekur procedura “Me negociim pa shpallje paraprake te njoftimit” dhe aktualisht eshte kryer dhe instaluar softi , sipas sspecifikimeve te përcaktuara nga njesia e prokurimit dhe afatet e përfundimit te saj.
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave ”Blerje dhe instalim i sistemit te akses kontrollit” miratuar me fond 400.000 leke dhe me proceduren e blerjeve me vlere te vogla eshte prokuruar fondi ne vleren 396.000 leke ose 100 % e fondit limit te parashikuar. i cili mundëson dhe realizon forcimit dhe disiplinimin e zbatimit te orarit te punes per punonjesit e Zyres se KMDP, rritjen dhe forcimin te masave te sigurise per hyrjen e personave te paautorizuar ne ambientet e brendshme te stafit si dhe forcimin dhe vendosjes se masave te sigurise ne ambientet e dhomes se servareve , ku menaxhohet dhe ruhet dokumentacioni i prodhuar i zyres se KMDP .
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Orendi e pajisje te tjera zyre “është miratuar nga Ministria e Financave vlere 1000 ne mije leke, dhe ne regjistrin e parashikimeve publike eshte ndare per prokurim ne nen artikujt e meposhtem
 - 1.1 “Blerje orendi, mobilje zyre “miratuar me fond 480.000 leke dhe me proceduren e blerjeve me vlere te vogla eshte prokuruar fondi ne vleren 479.000 leke ose 100 % e fondit limit te parashikuar “

1.2“Blerje pajisje te tjera zyre “ ” miratuar me fond 520.000 leke dhe me proceduren e blerjeve me vlere te vogla eshte prokuruar fondi ne vleren 501.830 ose 97 % e fondit limit te parashikuar .

- Fondi i alokuar “Garanci Punimesh” miratuar 52.000 nga Ministria e Financave dhe ne zbatim te detyrimeve kontraktuale dhe hartimit te proces verbalit per plotësimin e aftit 12 mujor te garancise punimeve u krye likuidimi i shumes ne favor te Shoqerise Prima Konstruksion” e cila kreu rikonstruksionin e ambienteve te brendshme te institucionit.

Fondi per shpenzime ne zerin Mallra dhe Shërbime (zeri 602), per vitin 2011, eshte planifikuar ne vleren 8149 (ne mije leke),me ndryshimet perkatese ne buxhetin e vitit 2011,.. Edhe per kete ze, per periudhen respektive eshte realizuar vlere prej 7966 ne mije leke ose 98 %, e planit vjetor, duke respektuar kerkesat e detajuara ne Regjistrin e Prokurimeve Publike, te miratuara edhe nga Agjensia e Prokurimeve Publike.

Ne pasqyren sipas **Formatit Nr 6** eshte paraqitur plani vjetor si dhe realizimi vjetor ne nivel programi, e ndarë sipas zerave kryesore te buxhetit.

Formati nr 7-Aneksi 9

Realizimi dhe monitorimi i perdorimit te fondeve publike ne nivel te pergjithshem programi dhe realizimi ka qene ne masen 95 % . .

Aneksi nr 9

Formati nr 8

Ne kete format eshte paraqitur realizimi i produkteve(ne sasi) nga kryerja e aktiviteve ne zbatim te objektivave dhe strategjise së miratuar per vitin 2011.

Konkretisht :

Persa i perket **produktit A Mbeshtetja me burime njerezore dhe financiare** ,realizimi eshte shprehur ne nr-muajsh.Ne vlere ne kete produkt jane perfshire sigurimi i sherbimeve te pergjithshme per te gjithë personelin , si furnizimi me uje, drita , telefon, sherbime sigurimi, sherbime abonimi per gjithë stafin si dhe furnizimi me mallra e sherbime te mbarevajtjes se punes se perditshme,kanceleri ,sherbime transporti,pjesemarrje ne trajnime brenda e jashte si dhe perfaqesime e pjesemarrje ne aktivite nderkombetare .

Produkti B Sherbime ligjore ,njesia matese e se ciles jane akte e udhezime te miratuara.sqarojme se per vitin jane miratuar strategjia per vitin 2011 dhe raporti vjetor i vitit 2010 ,jane pergatitur,miratuar dhe derguar per batim ne Fletore zyrtare 7(shtate) udhezime . te cilat kane si objekt zbatimin e rregullave per mbrojtjen e te dhenave personale qe i perkasin sektoreve te ndryshem si atij te komunikimit elektronik,gjyqesorit,hotelerise,punesimit,perdorimit te CCTV

etj.Gjithashtu eshte pergatitur dhe nje projekt vendim mbi disa ndryshime te Vendimit nr1,date 04.03.2010 ket projekt akte kane pasur asistences e projektit IPA -2009,jane miratuar 2 udhezime te reja e konkretisht udhezimi nr 10,date 6/09/2011'per perpunimin e te dhenave personale ne kuader te sherbimeve hoteliere 'botuar ne fletoren zyrtare nr.133,date 28/09/2011 si dhe udhezimi 11,date 8/09/2011"mbi perpunimin e te dhenave ne sektorin privat",botuar ne F.Zyrtare 133,date 28/09/2011. Ne aktet e miratuara perfshihet dhe Strategjia per trajnimet e stafit te KMDP per vitin 2011.

Per kete produkt bejme me dije se deri ne miratimin e akteve te Komisionerit,Udhezime e hartime te kodeve me institucione ne sektore te vecante, kryhen nje sere veprimtarish si studim legjislacioni, hartim projekt udhezimesh, dhenie e marrje mendimi ,te cilat kerkojne afatet e tyre kohore deri ne finalizimin, miratimin e publikimin e tyre.

Ne kuader te bashkepunimit me projektin jane pergatit 2 manuale proceduriale,dhe miratuar me urdherin nr 75,date 12.12.2011'Manuali per Vleresimin e kerkesave per Miratimin e Transferimit te te Dhenave ne shtetet e huaja.si dhe Manuali per ndjekjen e procedurave te njoftimit,drafti perfundimtar per amendimet e Ligjit 9887"Per mbrojtjen e te Dhenave personale 'derguar me mendim ne MITIK ,pergatitur dhe derguar per miratim ndryshimi ne rregulloren e brendshme te organizmit dhe funksionimit te keshillit te Ministrave , e cila do te mundesoje dhenien e mendimit nga KMDP per cdo akt ligjor e nenligjor perpara miratimit ne K.M

Jane nenshkruar dhe 5 marevshje bashkepunimi midis AKEP,Ministrise se Arsimit dhe Shkences, Autoriteteve homologe te Malit te ZiMaqedonise dhe Kosoves,

Ne kuader te perafimit me legjislacionin per mbrojtjen e te dhenave Personale dhe standartet europiane ,jane pergatitur amendimet e Ligjit 9749,"per Policine e shtetit" dhe ligjit 8792"per krijimin e Qendres se perpunimit te te Dhenave '.

Ne bashkepunim me DPP.Shtetit eshte pergatitur rregullarja e vecante e mbrojtjes se te Dhenave persona ,perfshire ne te masat e sigurise dhe e miratuar nga drejtopri i pergjithshme i Policise se Shtetit.

Eshte hartuar dhe miratuar Rregullarja e brendshme eper mbrojtjen e te dhenave personale dhe sigurine ne drejtorine e pergjithshme te Burgjeve e cila ka ne objekt te saj percaktimin e rregullave e parimeve te mbrojtjes se te dhanave personale e marrjen e masave per mbrojtjen e tyre ,ne funksion te ruajtjes dhe sigurise qe rrrjedhuin nga cenimi i te dhenave .

Jane trajtuar kerkesat per dhenie te Autorizimit te transferimit nderkombetar te te dhenave Personale.

Produkti C dhe D Botime dhe veprimtari ndergjegjesuese , produkt i shprehur ne numer botimesh, flete palosje e udhezues te ndryshem, sqarojme se per produktin C realizimi i tij eshte finalizuar tashme pas kryerjes se pjeses se perzgjedhjes, teksteve dhe dizenjimit te produktit e me pas ai eshte shumefishuar dhe i gatshem per shperndarje ne fushatat e ndermarra per ndergjegjesim.

Lidhur ngushte me kete produkt eshte edhe **Produkti D seminare ndergjegjesuese** ne drejtime e fusha te ndryshme sic jane realizimi i aktiviteteve me rastin e Dites Europiane te mbrojtjes se te dhenave personale, takime me studente te degeve te gazetarise te cilet jane me te ndjeshem ndaj publikimit apo rasteve te shkeljeve te te dhenave personale, takime ndergjegjesese me te rinjete e moshave 10-18, ne shkolla te ndryshme te rrethit te Tiranës, takime ne qendra tregtare ku frekuentohen nga nja mase e gjere e publikut, te cilet informohen periodikisht mbi privatesine, rastet e shkeljes dhe garantimin nga ligji per mbrojtjen e te dhenave personale, atje ku ato ekspozohen,

perpunohen apo transferohen ne kundershtim me ligjin. Gjithashtu ne kete produkt jane perfshire dhe emisionet televizive te herepashershme ,ne kuader te ndergjegjesimit te publikut.Shfaqja e spoteve televizive ne ekranet e Tvsh shqipatr si pjese e rendesishme e fushates ndergjegjesuese per te drejten e mbrojtjes se te dhenave personale .

Gjithashtu ne kuader te sensibilizimit dhe ndergjegjesimit jane marre kontakte te vazhdushme me mediat , ku cdo tre mujor jane dhene njoftime mbi veprimtarine e Zyres se komisionerit. Jane botuar ne gazeta te ndryshme shkrime mbi rrjete socilae apo dhe private ,te cilat mendojme se kane patura impakte pozitive , ne drejtim te mbrojtjes dhe ruajtjes se te dhenave personale , prej cenimve dhe keqperdorimit te tyre

Ne kuader te mareveshjes se lidhur me Ministrine e Arsimit , fale ndihmeses dhe bashkepunimit me Drejtorine Arsimore te rrethit te Tiranes,nepermjet psikologeve te shkollave eshte bere i mundur kontakti me nxenesit dhe ekspozimi i flete palosjeve ndergjegjesuese ne stendat e vendosura ne ambientet ne hyrje te shkollave . Kjo eshte mundesuar ne 85 shkolla publike dhe 89 shkolla private ku nga statistikat jane ndregjegjesuar rreth 82.000 nxenes.

Pjese e ktij produkti jane dhe takimet ,tavolinat e rumbullaketa ,seminaret e organizuara prane ambejnteve te zyrave te Komisionerit me kontrollues te fushave te ndryshme apo dhe semanre jashte zyrave ne ambiente sallash, te mundesuara nga Projekti IPA 2009, “Forcimi i Zyres se komisionerit per Mbrojtjen e te Dhenave Personale “e konktheisht projekti FIIAPP-PROGECO,me perfaqesues te kontrolluesve publike por edhe private .

Produkti E “Subjekte te regjistruar” njesia matese e se ciles eshte numer te regjistruarish subjektsh private e publike, eshte pjese e nje veprimtarie te gjere identifikimi,plotesimi informacioni para deklarimit zyrtar,vleresime ligjore te perpunimit te te dhenave personale te cilat do te perbejne bazen per evidentim te shkeljeve e shmangieve nga perpunimi i ligjshem dhe burim per hetim te metejshe,mareveshje institucionale me subjekte publike apo private per vendosjen e urave te komunikimit për sensibilizimin për njoftim, kontakte me media te shkruar e publikime te ndryshme ne deri ne formularin e njoftimit perfundimtar dhe regjistrimin ne regjistrin kombetar , i cili eshte burimi i vetem online i informacionit per publikun,me qellim informimin masiv dhe berjen transparente ndaj publikut se kush perpunon, pse dhe si.

Sqarojme se ne produktin e paraqitur ne sasi per vitin 2011, ne plan dhe ne fakt jane vendosur numri i pergjithshem i te regjistruarve qe nga momenti i fillimit te procesit te njoftimit dhe regjistrimit. Nese do te shprehemi vetem per vitin 2011 numri i regjistrimeve eshte 873 dhe i njoftimeve eshte 1043,nga keta 297 kontrollues publike dhe 699 kontrollues private .

Produkti E Inspektive dhe trajtim ankesash, njesia matese e te cilit eshte numer, eshte pjese e nje veprimtarie te gjere e cila perfshin kontrole tematike te planifikuara, publik apo private ,si dhe hetim e trajtime mbi baze ankesash te ardhura ne forma te ndryshme ,monitorime e ndjekje rekomandimesh te vendosura nga Zyra e KMDP,monitorime te regjistrit te njoftimeve dhe ne rast mos deklarimi te ketij detyrimi ligjor,indicje per vendosje te masave administrative me gjobe, e ne perfundim ndjekja e procedurave per egzekutim te tyre

Inspektimet jane fokusuar dhe realizuar per pjesen me te madhe ne Rrrethin e Tiranes pa nje kosto financiare sherbimesh sipas planit te miratuar vjetor , e vecanerisht rrethet , Durres Vlore ,Shkoder si dhe nje kontroll prane perfaqesive tona diplomatike e konkretisht ne Selanik te Greqise . kane vijuar rregullisht kontrollet

Ne kuader te realizimit te objektivave ka vijuar puna per ndjekjen e rekomandimeve te lena nga kontrollet e ushruarar per vitin 2010 dhe 2011.

Nese i referohemi vitiit 2010 ka nje rritje gati dyfish te kontrolleve dhe inspektimeve ,por me shume rekomandime ne drejtim te kontrolluesve,

Jane trajtuar 15 ankesa nga subjekte te te dhenave personale, nje pjese te te cilave jane dhene me shkrim ose eshte ushtruar inspektim administrativ per te verifikuar ne terren situaten e prashikuar ne ankese..

Jane vendosur 28 gjoba ne subjekte te ndryshme , te cilet jane evidentuar me shkelje administrative .

Aneksi nr 9

Formati nr 9

Ne kete format eshte paraqitur realizimi i produkteve(ne vlere) nga kryerja e aktiviteve ne zbatim te objektivve dhe strategjise se miratuar per vitin 2011.

Per cdo produkt eshte perfshire kosto e shpenzimeve per paga, sigurime, si dhe shpenzimet operative direkte te pjesemarrjes.

Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale , ka zbatuar me korrektesi te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Ligji per mbrojtjen e te Dhenave personale te, si dhe legjislacionin admnistrativo-financiar shqiptar.

Drejtores e Sherbimeve Mbështetëse

Lindita Morina

